

(MOS) ZBATIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

DISCLAIMER

COPYRIGHT © 2022. Kosova Democratic Institute (KDI). Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239

10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Autorët: **Albesa Humolli dhe Gzime Hashani**

Layout and design: **envinion**

PËRMBAJTJA

06

Lista e shkurtesave

07

METODOLOGJIA

09

1. PËR SINJALIZIMIN

10

2. MBROJTJA E SINJALIZUESVE
NË KOSOVË

12

3. INSTITUCIONET MBIKËQYRËSE
PËR ZBATIMIT TË LMS

14

ZBATIMI I LIGJIT PËR SINJALIZIM
NË SISTEMIN E DREJTËSISË
(GJETJET TE PARAQITEN NË DY
FAQE SI PIKA KRYESORE)

15

I. MOS-CAKTIMI I ZYRTARËVE
PËR SINJALIZIM NË
INSTITUCIONET E DREJTËSISË

16

II. MOS-PUBLIKIMI I EMRAVE
TË ZYRTARËVE PËRGJEGJËS
PËR SINJALIZIM NË UEB FAQET
INSTITUCIONEVE

17

III. NEGLIZHENCA E
INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË
NË SHPËRNDARJEN E
INFORMATAVE PËR SINJALIZIMIN
TEK PUNONJËSIT E TYRE

18

IV. MUNGESA E KUSHTEVE
TEKNIKE PËR TË SINJALIZUAR
BRENDA INSTITUCIONEVE TË
DREJTËSISË

19

V. MUNGESA E TRAJNIMEVE PËR
ZYRTARËT PËRGJEGJËS PËR
SINJALIZIM

20

VI. PROFILET E ZYRTARËVE
PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM

21

VII. ZERO (0) RASTE TË
SINJALIZIMIT

22

REKOMANDIMET



LISTA E SHKURTESAVE

LMI	Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve
LMS	Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
IP	Inspektorati i Punës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
GjTh	Gjykata Themelore
GjA	Gjykata e Apelit
GjS	Gjykata Supreme
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
PTh	Prokuroria Themelore
PA	Prokuroria e Apelit
ZKSh	Zyra e Kryeprokurorit të Shteti
PSh	Prokurori i Shtetit
MD	Ministria e Drejtësisë
RREGULLORJA	Rregullorja Nr. 03/2021 Për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (Rregullorja)



METODOLOGJIA

Për qëllim të këtij hulumtimi, KDI ka shqyrtuar kornizën ligjore që rregullon çështjen e sinjalizimit në Kosovë, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij ligji. Legjislacioni aktual përcakton një sërë obligimesh për institucionet, që lidhet me mënyrën e garantimit të sinjalizimit si mekanizëm parandalues i korrupsionit dhe formën e trajtimit të tyre. Zbatimi i këtyre obligimeve ligjore dhe nënligjore ka qenë objekt i shqyrtimit të këtij hulumtimi.

KDI, për realizimin e këtij hulumtimi ka përdorur metodën e intervistës. Me qëllim të ofrimit të një pasqyre gjithëpërfshirëse, KDI u është drejtuar me kërkesë për intervistë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorive Themelore, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykatave Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

Gjatë hulumtimit, fillimisht mbledhjes së informatave për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e drejtësisë dhe pastaj realizimin e intervistave me ta, KDI në disa raste ka hasur në vështirësi, që lidhen me marrjen e informatave (kontakteve) të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, pastaj me rezistencën e tyre për t'u intervistuar, bashkëpunuar apo për t'u deklaruar në lidhje me institucionin që ata përfaqësojnë.

Nga 22 institucione në tërësi të cilave KDI u është drejtuar me kërkesë për intervistë, tetëmbëdhjetë (18) u janë përgjigjur pozitivisht kërkesës, ndërsa katër (4) prej zyrtarëve kanë refuzuar në tërësi pjesëmarrjen në intervistë, ku njëri nga ta ka dhënë arsyetimin se nuk ka marrë leje nga eprori. Gjithashtu, nga tetëmbëdhjetë (18) zyrtarët e intervistuar, gjashtë (6) zyrtarë përgjegjës për sinjalizim fillimisht kanë hezitur të japin intervistë. Në dy (2) raste zyrtarët përgjegjës për sinjalizim nuk kanë pranuar intervistimin pa leje nga eprorët dhe vetëm pasi kanë siguruar leje nga eprori i tyre kanë pranuar ftesën e KDI për intervistë. Intervistat janë zhvilluar gjatë periudhës tetor – nëntor 2022.



Sinjalizimi është
mekanizmi për të
dhënë “informacionin
e duhur” tek “njerëzit
e duhur”





1. PËR SINJALIZIMIN

Sinjalizimi është mjet i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit sepse inkurajon qytetarët të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme publike duke denoncuar keqpërdorimet që mund të ndodhin në institucionet publike e private por edhe në shoqëri. Nëpërmjet sinjalizimit, një individ ka mundësinë që të raportojë apo zbulojë informata lidhur me veprimet që ndodhin në vendin e tij të punës, e të cilat cenojnë interesin publik. Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), përcakton që sinjalizues është çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.¹

Elementet e para të konceptit të sinjalizimit i hasim qysh në Anglinë e shekullit të XII, ku mbreti kishte vendosur se kushdo që raporton një keqbërje do të shpërblehej. Kjo deklaratë përfaqësoonte shembullin e parë të një ligji që lejon individët privatë të mbledhin një shpërblim për raportimin e një shkeljeje të legjisllacionit të vendit të tyre.² Më shumë statute të ngjashme u ngritën gjatë shekujve të ardhshëm edhe në shumë vende tjera për shkak të efektivitetit "të shpërblimit" në nxitjen e qytetarëve për të raportuar shkelësit e ligjit.

Në këtë drejtim, sinjalizimi si koncept është përqafuar dhe zhvilluar edhe në kulturën dhe politikën amerikane. Që nga themelimi i saj, Amerika ka nxitur dhe përqafuar një kulturë të përgjegjësisë qytetare për të mbrojtur të mirën publike. Benjamin Franklin u bë një nga sinjalizuesit e parë amerikanë kur në vitin 1773, ekspozoi letrat konfidenciale që tregonin se guvernatori i Massachusetts kishte mashtruar qëllimisht parlamentin për të promovuar një ngritje ushtarake në kolonitë amerikane.³

Gjatë viteve të fundit, Bashkimi Evropian (BE) ka ndërmarrë hapa për të forcuar të drejtat e sinjalizuesve, ndërsa në vitin 2019 miratoi edhe direktivën e re për "Mbrojtjen e personave që raportojnë për shkelje të ligjeve të Unionit" (Direktiva për Mbrojtjen e Sinjalizuesve). Kjo direktivë shënon hapin e parë të BE-së drejtë unifikimit të politikave në çështjen e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe për më tepër është hera e parë që BE ka një legjisllacion të dedikuar në këtë fushë. Nëpërmjet kësaj direktive sigurohet mbrojtje më e madhe për sinjalizuesit dhe mbrojtje nga hakmarrja nëpërmjet krijimit të "kanale të sigurta" për të raportuar shkeljet e ligjit. Të gjitha vendet anëtare të BE-së duhet ta transpozojnë direktivën në legjisllacionin e tyre kombëtar deri në dhjetor 2021. Megjithatë, shtetet e BE-së inkurajohen të miratojnë mbrojtje dhe stimuj më të mëdhenj për sinjalizuesit përtej standardit minimal të përcaktuar nga direktiva.

1 Neni 3, par.1.1, i Ligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

2 Whistleblowers History Overview, Whistleblowers International, e qasshme në <https://www.whistleblowersinternational.com/what-is-whistleblowing/history/>

3 Po aty.





2. MBROJTJA E SINJALIZUESVE NË KOSOVË

Sinjalizimi për herë të parë në Kosovë është rregulluar me Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve (LMI) të vitit 2011, ligj ky i cili përmbante 11 nene dhe synonte të përcaktojë procedurën e raportimit, trajtimit dhe mbrojtjes së informatorëve. Njëpërmjet këtij ligji çdo qytetar apo i punësuar motivohej të informonte me mirëbesim për çdo dyshim apo ekzistim të veprimit kundërligjor tek autoritetet përkatëse.⁴ Por dispozitat dhe fushë-veprimtaria e këtij ligji ishte tejet gjenerale dhe si e tillë vështirë e zbatueshme si për subjektet informuese ashtu edhe për autoritetet që pranonin këto informata.

Ndonëse ky ligj ishte mirëpritur nga shoqëria civile për risitë që kishte sjellë në fushën e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe zbulimit të informatave me interes publik, megjithatë ishte kritikuar për mbrojtjen e pamjaftueshme për subjektet që përfshiheshin në "sinjalizim". Problematik dhe dekurajues ishte vlerësuar dhe vetë emërtimi i ligjit, në kuptimin që ky ligj sinjalizuesit i quante "informatorë", term jo i përshtatshëm dhe me konotacion negativ historik gjatë regjimit komunist.⁵ Ky ligj përveç që nuk inkurajonte "informatorët" për të denoncuar veprime që ishin në dëm të interesit publik, gjithashtu ishte edhe në shpërputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Ndër të metat kryesore të këtij ligji ishin: pamundësia për të bërë raportim të jashtëm, mungesa e caktimit të personave përgjegjës (zyrtarëve për sinjalizim) në institucione për trajtimin dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit, mungesa e kanaleve të sigurta dhe të qarta të raportimit brenda institucionit apo mos-ndëshkueshmëria e punëdhënësve që hakmerreshin ndaj sinjalizuesve duke aplikuar përgjashimet nga puna apo degradimet në pozita. Gjithashtu ky ligj

ndër të tjera u tregua si vështirë i zbatueshëm në praktikë, meqenëse mungonin mekanizmat e duhur ligjor për monitorimin e zbatimit të tij.⁶

Për shkak të metave të shumta që pamundësonin zbatimin praktik të sinjalizimit në Kosovë, ky ligj u shfuqizua në vitin 2019, për t'i hapur rrugë miratimit të një ligji shumë më të avansuar në fushën e sinjalizimit, në harmoni edhe me Direktivën Evropiane. Kështu më 2 janar të vitit 2019 hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS) i cili kishte qenë hapi i parë drejt krijimit të një kornize të konsoliduar ligjore për sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve.

Ky ligj për dallim nga ligji i mëhershëm (Ligji për Informatorët) përcakton se sinjalizuesi që raporton apo shpalos informacion nuk është i obliguar të dëshmojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e raportimit të tij si dhe mundëson sinjalizimin e shkeljeve si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat⁷. LMS për më tepër përfshin edhe dispozita ligjore me të cilat rregullohet procedura e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Kapitulli i dytë i LMS përcakton të drejtat e sinjalizuesve për sinjalizimin e parregullsive dhe mbrojtjen e tyre derisa në kapitullin e tretë janë paraparë mënyrat apo llojet e sinjalizimit. Ndër të tjera LMS, parasheh edhe t'u sigurojë të punësuarve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat për sinjalizimin. Ky ligj përmban dispozita edhe sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve përfshirë edhe mbrojtjen gjyqësore nga veprimet e dëmshme si, shkarkimin nga puna, pezullimin nga puna, transferimin brenda ose jashtë

4 Ligji nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve

5 Kosovo: The Republic without Whistleblowers, BIRN, Kreshnik Gashi, 2016, e qasshme në <https://see-whistleblowing.org/kosovo-the-republic-without-whistleblowers/>

6 Whistleblowers in Kosovo Struggle for Protection, Flutura Kusari, 2016, e qasshme në <https://see-whistleblowing.org/whistleblowers-in-kosovo-struggle-for-protection/>

7 Neni 1, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve



Sinjalizimi në Kosovë mund të bëhet në tre mënyra:

- Sinjalizim i brendshëm - nënkupton raportimin brenda institucionit publik apo subjektit privat;
- Sinjalizim i jashtëm - nënkupton raportimin tek autoriteti kompetent.
- Sinjalizim publik, nënkupton shpalosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik.

institucionit publik ose subjektit privat pa pëlqimin e tij, uljen në pozitë, zvogëlimin e pagesës, humbjen e statusit dhe privilegjeve, mos ngritjen në pozitë e të tjera veprime të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës⁸. Tutje, LMS ka paraparë që organet kompetente për sinjalizimin e jashtëm janë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) për sektorin publik, dhe Inspektorati i Punës (IP) për sektorin privat sipas fushave të përgjegjësive.

Si obligim i cili rrjedh nga ky ligj Ministria e Drejtësisë (MD) në vitin 2021, ka miratuar Rregulloren Nr. 03/2021 Për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (Rregullorja) e cila ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përgjegjës. Kjo rregullore ka përcaktuar më në detaje obligimet e institucionit për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim si dhe obligimet në lidhje me sigurimin e burimeve të mjaftueshme për zyrtarin në përmbushjen e detyrave të tij si: hapësirë dhe pajisje për punë, kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve e të tjera.⁹

Sipas kësaj rregullore duhet të bëhet mbrojtja e raportimit si dhe zyrtarët përgjegjës kanë për detyrë të pranojnë dhe trajtojnë raportimet, të kryejnë hetimin administrativ në lidhje me raportimin, të përgatisin raport në lidhje me masat e rekomanduara pas vërtetimit se raportimi është në interes publik dhe i bazuar, të mbajnë regjistrin e sinjalizimeve dhe t'i mundësojnë sinjalizuesit qasje në shkresat e lëndës. Për më tepër ata përgatisin dhe dërgojnë tek punëdhënësi, për publikim në faqen zyrtare të institucionit, udhëzimet lidhur me sinjalizimin në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe janë të obliguar të përgatisin raporte në baza vjetore në lidhje me rastet e pranuar të sinjalizimit, të cilat me pas dërgohen në APK.¹⁰

KDI në përputhje me misionin e saj për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit ka dhënë kontribut në hartimin e LMS dhe rregullores por edhe në lehtësimin e zbatimit të këtij ligji në praktikë. Në këtë drejtim, së bashku me partnerët nga Transparency International në Holandë ka përpiluar një Komentari të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve me qëllim parësor për të ndihmuar autoritetet private/publike në zbatimin e këtij ligji duke përcaktuar kuptimin e secilës dispozitë dhe procedurën e nevojshme për zbatimin e tij.

Ky Komentari drejtohet kryesisht komunitetit të punonjësve në sektorin publik dhe privat, të cilët mund të përballen me shkelje të natyrave të ndryshme dhe që kanë vullnetin për t'i sinjalizuar ato. Duke ditur përmbajtjen dhe kuptimin e dispozitave ligjore, komuniteti i punonjësve do të krijojë siguri në lidhje me procedurën e njoftimit si dhe mbrojtjen e tyre nga pasojat e mundshme që mund të vijnë si pasojë e sinjalizimit. Por në të njëjtën kohë, ky Komentari do të shërbejë si një instrument i dobishëm për zyrtarët përgjegjës, institucionet publike, subjektet private që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

8 Neni 22, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

9 Neni 5, par.9, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

10 Neni 16, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit



3. INSTITUCIONET MBIKËQYRËSE PËR ZBATIMIT TË LMS

Sipas LMS dhe kompetencave të përcaktuara nga ky ligj, institucionet që janë mandatuar në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji janë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) – në institucionet e sektorit publik dhe Inspektorati i Punës (IP) – në institucionet e sektorit privat.

APK po ashtu ka për obligim të trajtojë të gjitha rastet e sinjalizimeve të jashtme, si edhe ato që mund të procedohen nga sektorët e tjerë publik. LMS si sinjalizim të jashtëm përcakton “sinjalizimin që bëhet nga ana e punonjësve jashtë institucionit”,¹¹ qoftë për shkak të mungesës së zyrtarit për sinjalizim në institucionin ku ata punojnë, qoftë për mungesë të besimit në zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, por edhe për arsye tjera. Në APK sinjalizimet nga jashtë trajtohen nga divizioni për sinjalizim që funksionon në kuadër të vetë agjencisë.

Obligim tjetër i APK-së sipas LMS-së, është hartimi i raportit vjetor për sinjalizim. Kështu, të gjitha institucionet publike, subjektet private si dhe rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi duhet të raportojnë çdo vit deri më 31 dhjetor, tek APK në lidhje me rastet e sinjalizimit të trajtuar brenda institucionit/subjektit për vitin paraprak.¹² Raportet vjetore këto institucioneve/subjekte duhet t'i paraqesin në APK deri më 31 janar të çdo viti. APK me pas përgatit dhe publikon deri më 31 mars, raportin vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak.¹³

APK ka përgjegjësi edhe përgatitjen e programeve të trajnimeve dhe mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucione publike, varësisht nga kërkesa e institucionit. Në lidhje me këtë çështje, APK gjerë tani ka zhvilluar vetëm një trajnim për zyrtarët për sinjalizim.

BOX: APK ka për obligim të mbajë trajnime të tilla, mirëpo po përballet me mungesë të buxhetit dhe se momentalisht e ka të pamundur të mbajë trajnime për zyrtarët për sinjalizim pa kontributin e ndonjë donatori të jashtëm.

Drejtori i APK, z. Yll Buleshkaj

11 Neni 1, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve
12 Po aty, Neni 29
13 Po aty.





Të gjitha institucionet publike, subjektet private si dhe rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi duhet të raportojnë çdo vit deri më 31 dhjetor, tek APK në lidhje me rastet e sinjalizimit të trajtuar brenda institucionit/subjektit për vitin paraprak.

Raportet vjetore këto institucioneve/subjekte duhet t'i paraqesin në APK deri më 31 janar të çdo viti. APK me pas përgatit dhe publikon deri më 31 mars, raportin vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak.

APK, përveç tjerash sipas rregullores është mandatuar që së bashku me MD të nxjerr dy udhëzues për zbatimin e ligjit për sinjalizim. Këta udhëzues është dashur të finalizohen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e rregullores, megjithatë përkundër se kanë kaluar më tepër se 1 vit nga hyrja në fuqi, këta udhëzues ende nuk janë publikuar. MD veçse ka iniciuar procedurat për hartimin e këtyre udhëzuesve duke krijuar një grup punues, ndërsa pritet që udhëzuesit të përfundojnë deri në fund të vitit 2022.¹⁴ Në anën tjetër mungesa e udhëzuesit për hetimin administrativ të raportimeve si dhe udhëzuesit për mbrojtjen së sinjalizuesve ka krijuar paqartësi edhe tek vetë zyrtaret për sinjalizim në lidhje me zbatimin e legjislacionit për sinjalizim.

Një përgjegjësi tjetër e APK është edhe monitorimi i zbatimit të LMS. Kësisoj çdo institucion duhet të informojë APK në lidhje me caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim dhe për çdo ndërrim eventual të zyrtarit për sinjalizim në kuadër të atij institucioni. Megjithatë APK nuk ka funksionalizuar ende mekanizmat për monitorimin e zbatimit të LMS dhe në lidhje me këtë çështje, z.Buleshkaj vlerëson se kapacitetet aktuale të APK (resurset humane dhe buxheti) nuk janë të mjaftueshme për të monitoruar zbatimin e këtij ligji. Buleshkaj vlerëson se mungesa e stafit në APK është problematike jo vetëm në monitorimin por edhe në vetë trajtimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm, për të cilin APK është e mandatuar me ligj.

Në këtë drejtim, APK nuk ka zhvilluar ndonjë fushatë vetëdijësuese për qytetarët në lidhje me sinjalizimin në përgjithësi apo sinjalizimin e jashtëm në këtë agjenci, kjo për shkak të ri-organizimit të brendshëm dhe buxhetit të kufizuar.

¹⁴ Intervistë me Drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z.Vll Buleshkaj, e datës 22.11.2022



ZBATIMI I LIGJIT PËR SINJALIZIM NË SISTEMIN E DREJTËSISË



I. Mos-caktimi i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim



II. Mos-publikimi i emrave të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim ne ueb faqet institucioneve përkatëse



III. Mos-shtrirja e informatës ne institucion ne lidhje me caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim



IV. Mungesa e kushteve teknike për sinjalizim



V. Mungesa e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim



VI. Profili i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim



VII. Zero (0) raste të sinjalizimit



I. Mos-caktimi i zyrtarëve për sinjalizim në institucionet e drejtësisë

LMS dhe Rregullorja përkatëse përcaktojnë obligimet e punëdhënësve në raport me zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve. Në kuadër të këtyre obligimeve është paraparë që punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës¹⁵ për sinjalizim si dhe të njoftojë me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit dhe të drejtat tjera të parapara me LMS. Rregullorja parasheh se institucionet publike të mëdha që kanë shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës, caktojnë zyrtarin përgjegjës për selinë qendrore, dhe njësitë regjionale të tyre caktojnë zyrtarin përgjegjës për secilën njësi.¹⁶

PROKURORITË

Në lidhje me përmbushjen e këtij obligimi ligjor, KDI ka gjetur se jo të gjitha institucionet në kuadër të sistemit prokurorial në Kosovë kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për sinjalizim. Në këtë drejtim, KDI me datë 10 tetor 2022, ka drejtuar një kërkesë për qasje në informata publike në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe ka kërkuar të dhënat e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit prokurorial. Edhe përkundër se kishin kaluar më tepër se dy javë nga kjo kërkesë, KDI nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga KPK. Kësisoj, KDI i është drejtuar institucioneve në kuadër të sistemit prokurorial me kërkesa individuale për qasje në informata, lidhur me caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. Pas gjithsej tre (3) javëve nga kërkesat e drejtuara KPK-së dhe institucioneve në kuadër të sistemit prokurorial, KDI ka arritur të siguroj kontaktet e personave përgjegjës për sinjalizim në sistemin prokurorial, ku nga gjithsej 11 institucione të kontaktuara, janë siguruar të dhënat e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në vetëm 8 prej tyre.

Hulumtimi i KDI-së ka gjetur se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), Prokuroria Themelore në Pejë (PTH Pejë) dhe KPK kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit vetëm pasi KDI u është drejtuar këtyre institucioneve me kërkesë zyrtare, ku ka kërkuar kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim.

GJYKATAT

Situata në sistemin gjyqësor vlerësohet të jetë pak më mirë, pasi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në mbledhjen 289-të, të mbajtur me datë 23 qershor 2022 kishte marrë vendim me të cilin ishin caktuar zyrtarët përgjegjës për sinjalizim nëpër gjykatat themelore në Kosovë, Gjykatën e Apelit (GjA), Gjykatën Supreme (GjS) dhe në KGJK. Ky vendim ishte publikuar në ueb faqen zyrtare të KGJK-së. Ndonëse një vendim i tillë kishte qenë i vonshëm për shkak se LMS ka hyrë në fuqi në vitin 2019 ndërsa rregullorja në vitin 2021, ndërsa KGJK ka caktuar zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në vitin 2022. Ndërsa Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore e Prizrenit dhe ajo e Gjakovës kishin caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim nga viti 2020.

KDI, vlerëson se caktimi i zyrtarëve për sinjalizim në sistemin e drejtësisë është bërë me vonesë, duke marrë për bazë se shumica e zyrtarëve janë caktuar përgjatë vitit 2022, përderisa LMS ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019.

¹⁵ Neni 17, par.1, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

¹⁶ Neni 5, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit





II. Mos-publikimi i emrave të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në ueb faqet institucioneve

Çdo punëdhënës publik (institucion publik) është i obliguar të publikojë në ueb faqe të tij udhëzime në lidhje me sinjalizimin.¹⁷ Gjithashtu në faqet zyrtare të institucioneve të figurojnë të dhënat dhe kontakti i personi përgjegjës për sinjalizim në kuadër të atij institucioni.¹⁸ KDI vlerëson se ky është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm që mundëson zbatimin e këtij ligji.

PROKURORITË

Hulumtimi i KDI-së ka gjetur se shumica e institucioneve në sistemin prokurorial nuk kanë publikuar të dhënat dhe kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. KDI fillimisht është qasur në ueb faqen zyrtare të KPK-së, për të marrë të dhënat lidhur me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit prokurorial, por këto të dhëna nuk kanë qenë publike, madje as për zyrtarin përgjegjës për sinjalizim në kuadër të KPK-së. Këtu, përjashtim bën Prokuroria Themelore në Mitrovicë, e cila kishte publikuar në ueb faqen e saj (vegëz) kontaktin dhe të dhënat e personit përgjegjës për sinjalizim për këtë prokurori.

Të dhënat për zyrtarët e tjerë përgjegjës për sinjalizim në sistemin prokurorial, KDI i ka siguruar përmes kërkesave për qasje informata të cilat i ka drejtuar në adresë të KPK-së dhe institucioneve tjera në sistemin prokurorial. KDI ka gjetur se pas këtyre kërkesave, KPK në nëntor 2022, ka publikuar listën e të gjithë zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit prokurorial.

GJYKATAT

Për dallim nga KPK, KGJK kishte publikuar në ueb faqen zyrtare të saj vendimin për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit gjyqësor. Përjashtim bëjnë Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, të cilat nuk kanë publikuar kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në ueb faqet e tyre.

17 Neni 6, par.2, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

18 Po aty, neni 6, par.3.2



III. Neglizhenca e institucioneve të drejtësisë në shpërndarjen e informatave për sinjalizimin tek punonjësit e tyre

LMS ka përcaktuar që institucionet publike e private, me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të punonjësve të tyre lidhur me sinjalizimin dhe procedurat e sinjalizimit, janë të obliguar të sigurojnë udhëzime me shkrim për punonjësit e tyre.¹⁹ Madje këto udhëzime apo informacione tjera të dobishme duhet të publikohen në ueb faqet e institucioneve, të përditësohen dhe shpërndahen rregullisht tek punonjësit, kur është e mundur teknikisht.

Për më tepër rregullorja përcakton se zyrtari përgjegjës ndërmerr veprime për të lehtësuar dorëzimin e raportimeve në interes publik, që përfshin vendosjen dhe shpërndarjen e formularëve për paraqitjen e raportimeve brenda institucionit, publikimi në faqen zyrtare të institucionit si dhe vendosjen e informatave se si një sinjalizues mund të kontaktoj zyrtarin përgjegjës për të dorëzuar një raportim në interes publik.

Mos përmbushja e këtij obligimi sipas LMS ka për pasojë shqiptimin e gjobave dhe atë prej pesëqind (500) euro deri në njëzet mijë (20.000) euro për institucionin publik, subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës.²⁰

PROKURORITË

Sipas zyrtarëve për sinjalizim të intervistuar nga KDI, shumica e stafit në sistemin prokurorial, e kanë të paqartë se "KUSH" është sinjalizues dhe "KU" duhet të raportojnë. Në fakt, shumica e prokurorive, vetëm në nëntor të vitit 2022, kanë lëvizur drejt zbatimit të LMS dhe atë duke bërë hapin e parë – caktimin e zyrtarëve përgjegjës që do të merren me trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Sipas zyrtarëve të intervistuar, po në nëntor të vitit 2022, i gjithë stafi në institucionet e sistemit prokurorial ka pranuar një email informues nga KPK, përmes të cilit janë informuar për kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit prokurorial. Në anën tjetër zyrtarët përgjegjës sinjalizim të intervistuar nga KDI kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me keqkuptimet që ekzistojnë tek punonjësit e institucioneve sa i përket sinjalizimit. Disa nga zyrtarët për sinjalizim përgjatë intervistave me KDI, kanë deklaruar se kolegët e tyre nuk kanë treguar ndonjë interes rreth sinjalizimit. Këta zyrtarë përmendin edhe faktin se institucionet ku ata punojnë nuk kanë zhvilluar ndonjë fushatë informuese për punonjësit e tyre mbi sinjalizimin. Andaj, që nga momenti i caktimit të tyre në këtë pozitë, shumica e zyrtarëve deklarojnë se për shkak të mungesës së informatave rreth sinjalizimit, në mes punonjësve janë krijuar situata të pakëndshme. Madje në disa raste, punonjësit e institucioneve u janë drejtuar zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim me terma pezhorativ – "shpiun".

GJYKATAT

Ndërkaq bazuar në intervistat e realizuara me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit gjyqësor mësohet se informimi i punonjësve ka qenë më i mirë. Personeli është informuar lidhur me kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim përmes emailave zyrtarë të cilat janë dërguar nga vetë zyrtarët për sinjalizim apo nga kryetarët e gjykatave, madje njoftime mbi kanalet e sinjalizimit janë bërë edhe gjatë mbledhjeve me stafin. Megjithatë, zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit gjyqësor tregojnë se nuk kanë pranuar ndonjë kërkesë për sqarime nga punonjësit në institucionin e tyre dhe nuk kanë përgatitur për publikim në faqen zyrtare të institucionit udhëzimet lidhur me sinjalizimin. Nga këto intervista mësohet se ka mungesë të theksuar të informatave tek personeli administrativ, madje sipas përgjigjeve të disa prej zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, personeli i këtyre institucioneve në raste të caktuara janë konfuz midis asaj se çka përbën shkelje disiplinore çka shkelje që trajtohen në kuadër të sinjalizimit e që kanë të bëjnë me interesin publik. KDI vlerëson se institucionet e drejtësisë, përveç faktit që kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për trajtuar rastet e sinjalizimit dhe atë me vonesë, përpjekjet e tyre për të informuar punonjësit e tyre për procedurat e sinjalizimit dhe të drejtat që burojnë nga ky ligj kanë qenë minimale, e në disa institucione edhe inekzistente.

¹⁹ Neni 28, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

²⁰ Po aty, neni 27



IV. Mungesa e kushteve teknike për të sinjalizuar brenda institucioneve të drejtësisë

LMS ka përcaktuar se zyrtari përgjegjës është personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.²¹ Sipas rregullores, zyrtarit përgjegjës duhet t'i sigurohen burime të mjaftueshme për të përmbushur detyrat e tij, përfshirë hapësirë dhe pajisje për punë, si dhe kushte të përshatshme për ruajtjen e dokumenteve.²²

Për më tepër, LMS ka paraparë se zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime në interes publik gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera.²³ Madje, Rregullorja përcakton se mosrespektimi i konfidencialitetit nga zyrtari përgjegjës dhe çdo personi tjetër i cili pranon raportime në interes publik do të konsiderohet si shkelje e detyrave të punës.²⁴

PROKURORITË

Hulumtimi i KDI-së ka gjetur gjysma e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet e sistemit prokurorial nuk kanë kushte të përshatshme të punës për të trajtuar rastet e sinjalizimit. KDI ka gjetur se pesë (5) nga 10 zyrtarët e intervistuar, ndajnë të njëjtin ambient pune me kolegët e tyre dhe nuk disponojnë zyra të ndara. Kjo gjendje është cilësuar problematike edhe nga vetë zyrtarët ngase nëse punonjësit e atij institucioni duan të sinjalizojnë, e kanë të pamundshme mbrojtjen e identitetit të tyre dhe konfidencialitetin e raportimit.

GJYKATAT

Në institucionet e sistemit gjyqësor kanë qenë të pakta rastet kur zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim nuk u është krijuar ambient i përshatshëm për të kryer punën e tyre (trajtimin e rasteve të sinjalizimit). KDI ka gjetur se tri (3) nga tetë (8) zyrtarët e intervistuar nuk kanë ambient të përshatshëm për zhvillimin e takimeve me sinjalizuesit. Për më tepër zyrtarët shpesh herë ndajnë zyrën më një apo dy persona dhe një gjë e tillë është në kundërshtim me njëri prej parimeve themelore të kësaj procedure siç është ai i konfidencialitetit, duke e penguar kështu zhvillimin e procedurës së sinjalizimit.

KDI vlerëson se zyrtarëve përgjegjës për pranimin e rasteve të sinjalizimit nuk u janë siguruar ambiente të përshatshme të punës për kryerjen e kësaj detyre, konform kërkesave ligjore.

21 Po aty, neni 3, par. 1.10

22 Neni 5.9, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

23 Neni 11, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

24 Neni 7, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit





V. Mungesa e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim

LMS përcakton një sërë obligimesh për institucionet publike dhe private, dhe atë jo vetëm në kuptim të caktimit të zyrtarit për sinjalizim por edhe në ofrimin e kushteve të përshtatshme për sinjalizuesit potencial. Vetë LMS është një koncept i ri në kornizën ligjore në fushën kundër korrupsion dhe si i tillë sjellë ndryshime sistematike, në kulturën qeverisëse e institucionale, por edhe në mentalitetin shoqëror - përmes motivimit të qytetarëve për të vepruar në të mirë të interesit publik.

Kështu, zbatimi efikas i tij kërkon një vullnet dhe përkushtim shumëdimensional dhe paraqet një sfidë për institucionet publike e private. Zbatimi i ligjit është i lidhur drejtpërdrejt me kapacitetin e zyrtarëve përgjegjës në institucionet publike e private për të trajtuar në mënyrë profesionale e adekuate rastet e sinjalizimit. Për këtë, trajnimet kualitative dhe të mjaftueshme për zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin duhet të jenë në plan të parë në mënyrë që të sigurojnë zbatueshmërinë e ligjit. Rregullorja në fuqi përcakton obligimin ligjor për institucionet përkatëse për të ofruar trajnime për zyrtarët për sinjalizim ndërsa mandaton APK që sipas kërkesës së institucioneve publike të përgatisë programin e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.²⁵

PROKURORITË

Nga intervistat e realizuara me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në sistemin prokurorial, KDI ka kuptuar se shumica e tyre nuk janë trajnuar për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, përkundër faktit që janë ngarkuar me këtë detyrë shtesë, pa ndonjë kompensim. Nga gjithsej 11 zyrtarë përgjegjës, vetëm 4 nga ta i janë nënshtruar trajnimit për sinjalizimin. Të gjithë zyrtarët pa përjashtim, edhe ata që nuk janë trajnuar, por edhe ata që kanë kaluar në një trajnim të vetëm kanë shprehur nevojën që të ndjekin trajnime shtesë, meqë kjo për ta është një detyrë e re për të cilën nuk kanë njohuri të mjaftueshme. Po ashtu, zyrtarët e intervistuar kanë shprehur se nuk i kanë të qarta procedurat për trajtimin dhe hetimin e sinjalizimeve të marra.

GJYKATAT

Edhe në sistemin gjyqësor, zyrtarët përgjegjës kanë potencuar se nuk janë trajnuar për trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Përpos GjTh në Gjakovë, të gjithë zyrtarët përgjegjës të caktuar për sinjalizim kanë konsideruar të nevojshme mbajtjen e trajnimeve për sinjalizim.

Në anën tjetër trajnimet nuk kanë qenë obligative dhe ka pasur raste kur zyrtarët nuk kanë marr pjesë nëpër këto trajnime fare, pra ligji nuk ka ndonjë mekanizëm obligues për mbajtjen e trajnimeve për këta zyrtarë, ndonëse nga përgjigjet e dhëna për KDI zyrtarët në fjalë kanë shprehur nevojën për të qenë pjesë e trajnimeve duke konsideruar sinjalizimin si një fushë të re për të cilën nuk është se kanë pasur njohuri.

KDI vlerëson se mbajtja e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës është kruciale në zbatimin efikas të detyrave të këtyre zyrtarëve dhe vetë ligjit.

²⁵ Po aty, neni 5, par.12





VI. Profilet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim

LMS nuk përcakton ndonjë kriter të qartë në lidhje me përgatitjet profesionale që një zyrtar përgjegjës për sinjalizim duhet t'i ketë para se të marrë këtë detyrë, ndërsa rregullorja në fuqi përcakton se “zyrtar përgjegjës për sinjalizim” mund të jenë ndonjë zyrtar i atij institucioni që është i mandatuar për të trajtuar çështje që lidhen me etikën, politikën e luftimit të korrupsionit ose çështjet e ndërlidhura.²⁶

PROKURORITË

Nga intervistat e zhvilluara në sistemin prokurorial, KDI ka gjetur se zyrtarët për sinjalizim u takojnë profileve të ndryshme, disa janë staf administrativ ndërsa të tjerët ushtrojnë edhe pozitën e prokurorit. Secili prej tyre është ngarkuar me këtë detyrë shtesë, pa kompensim, për të trajtuar rastet e sinjalizimit brenda institucionit ku janë të punësuar sipas detyrës primare.

Ata kanë shprehur se detyra shtesë e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim edhe mund të interferojë në ushtrimin efektiv të detyrës parësore që ata ushtrojnë. Kjo ankesë sidomos ka qenë e shprehur tek prokurorët, të cilëve u është ngarkuar kjo detyrë, meqë puna e tyre parësore ka mjaft obligime, shpesh edhe me punë jashtë zyrës.

GJYKATAT

Ndërsa, në sistemin gjyqësor, ato kanë caktuar bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët për informim publik apo zyrtarët për qasje në dokumente zyrtare si zyrtarë përgjegjës për sinjalizim.

Sa i përket zyrtarëve për informim publik të cilët shumicën e rasteve janë edhe zyrtarë për qasje në dokumente publike, të njëjtit kanë një ngarkesë të madhe andaj përgjegjësia shtesë e zyrtarit për sinjalizim si dhe pranimi i rasteve të sinjalizimit mund t'ju pengojë në ushtrimin e funksionit parësor.

²⁶ Po aty, neni 5, par.2





VII. Zero (0) raste të sinjalizimit

Korniza ligjore për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit ka përcaktuar obligime ligjore për institucionet me qëllim që të fuqizoj luftimin e korrupsionit përmes sinjalizimit.

Përkundër se LMS ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019 ndërsa rregullorja në maj të vitit 2021, zbatimi i tyre nga institucionet e sistemit të drejtësisë ka filluar me vonesë. Caktimi i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në prokurori është bërë kryesisht gjatë vitit 2022. Në fakt 4 nga 11 zyrtarë përgjegjës janë caktuar në detyrë vetëm pasi KDI kishte kërkuar kontaktet e tyre për intervistë, në nëntor të këtij viti. Edhe në gjykata, zyrtarët përgjegjës për sinjalizim janë caktuar në detyra në qershor të vitit 2022, pra dy (2) vite e gjysmë pas hyrjes në fuqi të LMS dhe mbi një vit pas hyrjes në fuqi të rregullores.

Për rrjedhojë, numri i rasteve të sinjalizimit brenda sistemit të drejtësisë për periudhën janar 2022 deri në nëntor 2022 është zero (0) raste të sinjalizimit.





REKOMANDIMET

- Institucionet e sistemit të drejtësisë, të caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim. Në rastet kur zyrtarët e caktuar japin dorëheqje për çfarëdo arsye, të respektohen afatet ligjore në raport me caktimin e zyrtarit të ri përgjegjës për sinjalizim si dhe të njohet APK.
- Të publikohen emrat dhe kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në ueb faqet zyrtare të gjykatave dhe prokurorive, në mënyrë që punonjësit por edhe publiku të kenë qasje në këto kontakte.
- Institucionet e sistemit të drejtësisë të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes dhe kulturën kundër-korrupsion duke ndër-marrë të gjitha masat në drejtim të informimit të të gjithë punonjësve të tyre mbi të drejtën dhe procedurat e sinjalizimit, por edhe duke inkurajuar sinjalizimin si vlerë në të mirë të interesit publik.
- Institucionet e sistemit të drejtësisë të ofrojnë kushte fizike dhe teknike të përshtatshme për sinjalizim brenda hapësirave të tyre në mënyrë që sinjalizuesve t'u mbrohet identiteti dhe konfidencialiteti, në përputhje me ligjin.
- APK të organizojë programe trajnimi të vazhdueshme për zyrtarët e përgjegjës për të trajtuar me efikasitet dhe profesionalizëm rastet e sinjalizimit në institucionet e drejtësisë.
- Të zhvillohen trajnime nga Akademia e Drejtësisë edhe për personelin administrativ në mënyrë që të njëjtit të informohen mbi procedurën e sinjalizimit dhe të drejtat e sinjalizuesve.
- Të parashihen kritere të qarta në lidhje me përzgjedhjen e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim kjo për të mundësuar sinjalizim efikas brenda një institucioni si dhe për të evituar mundësinë e interferimit të kësaj detyre shtesë në detyrën parësore të zyrtarit.
- Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregullorja duhet të hartojnë udhëzuesit për mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet në interes publik, obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore si dhe udhëzuesin për mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ.





PYETËSORI NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE - KDI

1 Kur e keni marrë detyrën si përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit?

2 A ndiheni profesionalisht të përgatitur për të ushtruar këto detyra që u janë ngarkuar?

- 1 mjaftueshëm
- 2 jo mjaftueshëm
- 3 aspak

3 A jeni trajnuar për këtë? Nëse po, Kur dhe nga Kush?

4 Çfarë materiale ju kanë dhënë në dispozicion (Ligjin, Rregullorja, Komentari etj)?

5 Sa është shtrirë informata në institucionin ku ju punoni për rolin tuaj?





6 Si është komunikuar kjo me stafin (email, telefon, mbledhje...)?

7 A ka pasur ndonjë rast sinjalizimi që ju keni trajtuar? Nëse Po, Kur?

8 A u është drejtuar ndonjë punonjës në institucionin tuaj me kërkesë për ndonjë informatë rreth sinjalizimit?

9 A keni ambient të përshtatshëm për takime me palë (sinjalizues)?

10 A keni nevojë për trajnime shtesë?

11 Cilat kanë qenë vështirësitë (sfidat) tuaja, nëse ka pasur?

12 A ka ndikuar detyra shtesë e zyrtarit për sinjalizim në përmbushjen e detyrave të punës?





SISTEMI GJYQËSOR

8 nga **10**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim u janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për intervistim

4 nga **8**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim fillimisht kanë hezitur për të marr pjesë në intervistë

3 nga **8**



zyrtarët të intervistuar nuk kanë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e takimeve me sinjalizuesit.

2 nga **8**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim nuk kanë marr pjesë në trajnime

4 nga **10**



institucione në sistemin gjyqësor nuk kanë publikuar kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në ueb faqet e tyre.



SISTEMI PROKURORIAL

10 nga **11**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim u janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për intervistë

2 nga **10**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim kanë hezitur të marrin pjesë në intervistë

5 nga **10**



zyrtarët të intervistuar nuk kanë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e takimeve me sinjalizuesit.

4 nga **10**



zyrtarë përgjegjës për sinjalizim të intervistuar kanë mbajtur trajnime

10 nga **11**



institucione të sistemit prokurorial nuk kanë publikuar kontaktet e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në ueb faqet e tyre.

|||||

|||||

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), beson në një Kosovë ku qeveria, bizneset, shoqëria civile dhe jeta e përditshme e qytetarëve janë të lira nga korrupsioni. KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe luftën kundër korrupsion përmes promovimit të transparencës, llograihënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme e Gjermanisë



RAPORTO KORRUPSIONIN

THIRR

0800
77 777

ose online në linkun
<https://raporto.kdi-kosova.org/>

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**